



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:064369
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05726658

K.DH.SH.II.nr.617/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit NLB Kasabank sh.a, me seli ne Prishtinë te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Debt Loan Recovery nga Prishtina, ndaj debitorëve 1. N.P.T “Metro” me seli ne Prizren te cilin e përfaqëson pronari U.G. nga Prizreni, 2. NHPT “Xharra Plast” me NUI810585565, me seli ne Prizren, me pronar D.Xh., te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Visar Ostrazubi avokat nga Prizreni, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.203/23 dt.26.12.2023, me datën 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e kreditorit NLB Kasabank sh.a, me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.203/23 dt.26.12.2023 Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.203/23 dt.26.12.2023, e ka aprovuar si te bazuar prapësimin e debitorit NHPT “Xharra Plast” me NUI810585565, me seli ne Prizren, me pronar D.Xh. dhe urdhrin përmbarimor P.nr.12/21 dt.03.02.2021 i lejuar nga përmbaruesi privat Jeton Krasniqi e ka shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi, ne afat ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te shkeljeve procedurale te Ligjit për Procedurën Kontestimore, vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe shkeljes e te drejtës materiale nga LMD, propozon qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ne tërësi ankesën e kreditorit, aktvendimin e atakuar ta ndryshoj dhe debitorët te detyrohen ta përmbushin obligimin si dhe te paguajnë shpenzimet përmbarimore.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NLB Kasabank me sh.a ne Prishtinë, me datën 29.10.2007, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorëve 1. N.P.T “Metro” me seli ne Prizren te cilin e përfaqëson pronari U.G. nga Prizreni, 2. NHPT “Xharra Plast” me NUI 810585565, me seli ne Prizren me pronar D.Xh., ne bazë te dokumentit përmbartimor–Kontrata mbi Mbitërheqje nr.270081/07 dt.26.09.2006, Kontrata mbiu Pengun e date 26.09.2006, Lista e Kolateralit dt.26.09.2006, Procesverbali i dt.26.09.2006 dhe Marrëveshja Garantuese dt.26.09.2206. Gjykata Komunale ne Prizren ka lejuar përmbartimin me Aktvendimin për përmbartim E.nr. 2664/07 dt.31.10.2007, për shumën e detyrimit në vlerë totale prej 10,943.75 euro.

Ndaj urdhrit përmbartimor, me datën 25.03.2021, ka ushtruar prapësim debitori NHPT “Xharra Plast” me seli ne Prizren te cilin e përfaqëson D.Xh. nga Prizreni e ushtruar përmes përfaqësuesit te tij avokat Visar Ostrozubi, me pretendimin se debitori Xharra Palst është garantues me sende te luajtshme dhe vetëm ne rast te pamundësisë për përmbartim nga ana e huamarrësit dhe bashkë huamarrësit mund te kërkohet pagimi i detyrimit nga ai. Debitori nuk ka pranuar asnjë shkresë e as aktvendim mbi lejimin e përmbartimit duke mos u njoftuar asnjëherë me cilësinë e tij për detyrimin e mbetur pa u paguar. Përmbartuesi privat pa dorëzuar asnjë dokument ku është mbështetur propozimi, ndërmerr veprime përmbartimore ndaj debitorit me bllokim te llogarive. Më anë te këtij urdhri është bërë edhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike pasi qe nuk është i qartë se a është paguar detyrimi nga huamarrësit për te cilët obligohet debitori Xharra Palst. Edhe kamata e kërkuar prej 14.4% mujore është joligjore dhe si e tillë nuk mund te përmbartohet. Andaj nga këto edhe propozon qe gjykata ne rastin e shqyrtimit te këtij prapësimi te caktoj seance gjyqësore për te shpjeguar te gjitha pretendimet e palës debitorë.

Përgjigje ndaj prapësimi te debitorit ka ushtruar kreditori me datë 26.03.2021, me pretendimin se arsyetimet ne prapësim janë te pabazuara. Ne disa herë e kemi njoftuar debitorin përmes vizitave ne adresat e tyre dhe përmes telefonit për mos përmbushjen e obligimit ndaj kreditorit NLB Bankë por te njëjtit janë përgjigjur “vazhdoni ju me procedurat e juaja lirisht sepse nuk jemi te interesuar te paguajmë”, sa i përket lartësisë se obligimit organi përmbartues nuk është organ kompetent te vendos për obligimin e debitorit ndaj kreditorit, bashkangjitur gjykatës ia përcjellim edhe kartelën e qarkullimit për mbitërheqje, propozon qe gjykata ta hudh poshtë si te pabazuar prapësimin debitorit dhe te vazhdohet me procedurën e përmbartimit deri ne përmbushje te obligimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës –Dhoma e Shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.203/23 të datës 26.12.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se duke vepruar sipas udhëzimeve të shkallës së dytë në aktvendimin K.DH.SH.II.nr.422/22 dt.25.01.2023, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore dhe pas deklarimit të palëve dhe provave ka caktuar afatin shtesë që kreditorit ti sjell dokumentet origjinale dhe pas parashtrimit të dokumentacionit origjinal nga kreditori ka vazhduar me vlerësimin e provave në lëndë dhe pretendimeve të palëve. Gjykata ka gjetur se gjetur se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar referuar këtij nenit 21 të LPP dhe nenit 5 par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimorë. Gjykata ka shqyrtuar marrëveshjet e Pengut të datës 26.09.2006 nga e cilat konstaton se kreditori nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimeve nga Xharra Palast i cili paraqitet vetëm si garantues i kontratës për kredi e cila nuk është dokument përmbarimor në rastin konkret. Kreditori është i detyruar të kërkojë përmbarimin nga debitorët Metro NPT dhe nga B.G. dhe Donin Trade NTPQSH të cilët figurojnë si debitor por jo edhe Xharra Plast i cili nuk është pënglënës në kontratën e Pengut. Gjykata i referohet nenit 71 par.11 pika 1.6 e LPP, andaj ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë, bazuar në shkresat e lëndës vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt me rastin e vendosjes sepse e njëjta ka çmuar sakte dhe drejte rrethanat dhe provat e lëndës përkatësisht dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi në këtë çështje. Sipas Kontratës mbi Mbitërheqje nr.270081/07 dt.26.09.2006, nuk rezulton se debitori NHPT Xharra Plast është në cilësinë e garantuesit e po ashtu as nga Kontrata mbi Pengun e datës 26.09.2006 nuk rezulton si pënglënës debitori NHPT Xharra Plast. Pra nga këto dokumente mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi nuk del te jetë debitori NHPT Xharra Plast në cilësi të pënglënësit të Kontratës së Kredisë kryesore, ashtu që kreditori nuk mund ta kërkojë përmbushjen e detyrimit nga i njëjti e kjo bazuar në nenin 71 par.1 nenpar.1.6, i cili parasheh që *“kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin kundër debitorit”*, e që në rastin konkret kreditori është i detyruar ta kërkojë përmbushjen detyrimit nga debitorët kryesor të cilët kanë nënshkruar Kontratën e Pengut me kreditorin.

Me tej kjo gjykatë vlerëson se nga Kontrata Garantuese e datës 26.09.2006 e lidhur mes kreditorit NLB Kasabank dhe debitorit NHPT Xharra Plast, e cila gjendet ne shkresa te lendes, del se debitori Xharra Plast kishte garantuar vetëm ne rast te vonesave te kthimit te një apo me shumë kësteve nga ana e debitorit NPT “Metro”- U.G., ndërsa nga shkresat ne lende nuk rezulton me ndonjë prove shkresore se kreditori i është drejtuar debitorit NHPT Xharra Plast me ndonjë precizim te qartë se debitori - kredi marres dhe penglënës nuk ka vepruar ne pajtim me kushtet e kontratës për kredinë dhe për përmbushjen e detyrimit te debitorit kryesor dhe nuk ka precizuar saktë se sa është detyrimin i mbetur si i papaguar nga debitori kryesor për te cilat debitori garantues NHPT Xharra Plast duhet përgjigjur sipas Marrëveshjes Garantuese. Kjo gjykate me këtë rast pati parasysh faktin se ne Marrëveshjen Garantuese është precizuar qartë se: *“Garantuesi është pajtuar qe nëse huamarrësi nuk i kryen te gjitha detyrimet kontraktuese te specifikuar ne kontratën kreditore, mjetet e lëna peng nga garantuesi mund te shfrytëzohen nga KSB me vëllimin e mosrealizimit te detyrimeve nga KSB sipas kontratës mbi ndarjen e kredisë”*

Andaj bazuar ne këtë gjendje, pretendimin e kreditorit se te dy palët janë te ndërlidhura ne një kredi, sepse siç shihet nga Marrëveshja e Pengut, Marrëveshja për Mbitërheqje dhe Marrëveshja garantuese te gjitha kanë te njëjtën datë çka do te thotë se te gjitha palët kane marrë përgjegjësinë për mos kthimin e kredisë, por, kjo gjykatë e vlerësoi si te pabazuar sepse as nga Kontrata e pengut e as nga Kontrata për Mbitërheqje nuk rezulton se debitori NHPT Xharra Plast është debitor kryesor, prandaj edhe e refuzoi si te tillë ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.617/42, me datë 22.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi